



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/189

Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 178, 179, 180, 181 dhe 182 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/189

Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës themelon komision qeveritar i cili do të kryej analizat përkatëse për themelimin e Fondit për punësim dhe zhvillim në përbërjen në vazhdim:
  - 1.1 një përfaqësues nga Ministria e Financave, kryesues;
  - 1.2 dy përfaqësues nga Ministria e Financave, anëtarë;
  - 1.3 një përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
  - 1.4 një përfaqësues nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
  - 1.5 një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë e Republikës së Kosovës;
  - 1.6 një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
  - 1.7 një përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
  - 1.8 një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
  - 1.9 një përfaqësues nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
2. Komisioni Qeveritar mund të ftoj edhe përfaqësues tjerë nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe nga sektori i Biznesit të cilit mund t'i kontribuojnë zhvillimit të fondit.
3. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi ka për të detyrë që të analizojë bazën ligjore, institucionale, si dhe politikat ekonomike të Republikës së Kosovës me qëllim të ofrimit të një kornize ligjore dhe institucionale mbi bazën e së cilës do të themelohet dhe funksionojë Fondi për Punësim dhe Zhvillim.

4. Pas kryerjes së analizave, Komisioni ka për detyrë të hartojë një koncept dokument të detajuar mbi bazën e të cilit, Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendos mbi themelimin e fondit për punësim dhe zhvillim. Ky koncept dokument duhet që në mënyrë të qartë të dërgoj edhe bazën ligjore që nevojitet të krijohet dhe ndryshohet për t'i paraprirë themelimit të fondit për punësim dhe zhvillim.
  
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/189

Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia për Rregullim më të Mirë 2014-2020.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/189

Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

**Për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e marrëveshjes në mes të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për të përmirësuar përputhshmërinë e rregulloreve tatimore në nivelin ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve të FATCA-s**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes në mes të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për të përmirësuar përputhshmërinë e rregulloreve tatimore në nivelin ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve të FATCA-s.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, komform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THIAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/189

Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Task Forcës Ndërinstitucionale për lehtësimin e lëvizjes së personave, mjeteve dhe mallrave në kufirin Kosovë - Shqipëri**

1. Themelohet Task Forca Ndërinstitucionale për Lehtësimin e Lëvizjes së Personave, Mjeteve dhe Mallrave në Kufirin Kosovë - Shqipëri midis të gjitha institucioneve qeveritare që veprojnë në kufi, në përbërjen si vijon:
  - 1.1. Drejtori i Doganave të Kosovës, Kryetar;
  - 1.2. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, Anëtar;
  - 1.3. Drejtori i Departamentit të Kufirit të Policisë së Kosovës, Anëtar;
  - 1.4. Drejtori i Departamentit të Transportit Rrugor i Ministrisë së Infrastrukturës, Anëtar;
  - 1.5. Drejtori i Departamentit të Inspektoratit i Ministrisë së Infrastrukturës, Anëtar;
2. Në mbledhjen e Task Forcës Ndërinstitucionale, në varësi të çështjeve që do të diskutohen, ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të agjencive qeveritare të zbatimit të ligjit.
3. Dogana e Republikës së Kosovës do të kryejë edhe rolin e sekretarisë teknike për koordinimin e strukturave si dhe gjatë zhvillimit të takimeve.
4. Task Forca Ndërinstitucionale për Lehtësimin e Lëvizjes së Personave, Mjeteve dhe Mallrave në Kufirin Shqipëri-Kosovë do të ketë për qëllim:
  - 4.1 Të mundësojë përshpejtimin e lëvizjes së pasagjerëve dhe të mjeteve të tyre të transportit;
  - 4.2 Të mundësojë përshpejtimin e lëvizjes dhe tranzitimit të mallrave Kosovë - Shqipëri dhe anasjelltas;

- 4.3 Të thjeshtësojë dhe të përshpejtojë kontrollet policore të migracionit;
- 4.4 Të unifikojë dhe të bëjë barasvlefshmërinë duke u njohur reciprokisht midis vendeve dokumentet e kontrollit fitosanitar dhe të peshës së mallit;
- 4.5 Të realizojë ndërhyrjet emergjente infrastrukturore dhe procedurale në funksion të rritjes së fluksit të pasagjerëve dhe të mallrave si dhe të projektojë ndërhyrjet afatmesme duke synuar krijimin e një terminali të përbashkët doganor-policor.
5. Task Forca Ndërinstitucionale raporton periodikisht tek Kryeministri mbi ecuritë dhe rezultatet konkrete të arritura.
6. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI  

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/189

Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

**Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/186 datë 29. 04.2014**

1. Në pikën 1.3 të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/186 datë 29. 04.2014, teksti me fjalët "3 vite" zëvendësohet me tekstin "4 vite".
2. Në pikën 1.4 të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/186 datë 29. 04.2014, teksti me fjalët "1 vit" zëvendësohet me tekstin "3 vite".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/189

Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 350,000.00 (treqind e pesëdhjetëmijë) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezerva e Qeverisë shpenzimet e paparashikuara kategoria ekonomike kapitale dhe barten në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve shuma prej 237,000.00 euro dhe në kategorinë paga dhe mëditje shuma prej 113,000.00 euro.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/189

Datë: 23.05.2014


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i ngastrave kadastrale në të cilat ndodhen Objektet e ish NSH "Rilindja" Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.



6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI  
  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/189

Datë: 23.05.2014


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nën paragrafit 3.1 të nenit 4 dhe paragrafit 5 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim të përhershëm dhe me krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Linjës Energjetike 400 kV Kosovë-Shqipëri, segmenti II-dytë 32 km, Zonat Kadastrale Gllanasellë, Çikatovë e Vjetër, Gllobar, Çikatovë e Re, Domanek, Krajkovë, Lllapushnik, Negroc, Arllat të Komunës së Drenasit dhe Zonat Kadastrale Balincë, Vermicë, Shkarashnik, Llashka Drenovc, Carrallukë, Mirushë, Dragobil dhe Burim të Komunës së Malishevës, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 13/2011 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit/MMPH, Ministria e Financave dhe KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit të Tregut Sh.A).
4. Mjetet financiare për kompensimin e shpronësimit do t'i siguroj Subjekti Kërkues, Kompania KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit të Tregut Sh.A).



5. Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/189

Datë: 23.05.2014


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit cilat preken nga ndërtimi i Linjës Energjetike 400kV Kosovë-Shqipëri, Segmenti I-parë 16 km, Zonat Kadastrale Obiliq dhe Plemetin të Komunës Obiliq, Zonat Kadastrale Prilluzhe, Bivolak, Strofc dhe Zhilivode të Komunës së Vushtrisë dhe Zonat Kadastrale Gradicë dhe Gllanasellë, Komuna Drenas, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cילו person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.



6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Kompania Publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" Sh.A. (KOSTT) do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/189

Datë: 23.05.2014


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale Dimce, Komuna Hani i Elezit, e të cilat duhet të shpronësohen për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore të bartësit të licencës së lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale(KPMM), subjektit: Kompanisë Sharrcem Sh.P.K, për sigurimin e lëndës së parë për prodhimin e çimentos dhe ushtrimin e të drejtave të tij në bazë të kësaj licence, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit(MMPH), Ministria e Financave dhe Kompania Sharrcem Sh.P.K-Hani i Elezit.



5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/189

Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Për inicimin dhe zhvillimin e procedurave ligjore për themelimin e Komunës së re të Kijevës, Komoranit, Rugovë të Pejës, si dhe Hogosht të Kamenicës, bazuar në Kreun II të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të ndërmerr të gjitha veprimet ligjore që ndikojnë në themelimin komunave të reja Kijevë, Komoran, Rugovë të Pejës, si dhe Komunës së Hogoshtit në pajtim me vendimin e Qeverisë nr. 02/170 të datës 14 shkurt 2014, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.
3. Ministrinë dhe komunat të cilat ndërlidhen me procesin e zbatimit të kushteve ligjore për themelimin e këtyre komunave të reja, janë të obliguara të ofrojnë përkrahje të vazhdueshme, sipas kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/189


Datë: 23.05.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-233 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Me Ligjin Nr. 04/L-233 të për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 në OB 215 Ministria e Drejtësisë, është krijuar Programi 375 Njësia Kundër Krimeve Ekonomike dhe është ndarë Buxhet në kategorinë Paga dhe Mëditje për vitin 2014 në shumën 46.746.00 (Dyzetegjashtë mijë e shtatëqindedyzetegjashtë euro), në mbështetje të kësaj caktohet shtesa mujore si vijon:
  - 1.1. Për koordinatorin kundër krimeve ekonomike në shumë prej 800.00€ (tetëqind euro) në muaj;
  - 1.2. Për stafin tjetër profesional-mbështetës prej gjashtë (6) zyrtarëve në shumë prej 350.00 0€ (treqind e pesëdhjetë euro) në muaj.
2. Paga bazë e stafit bëhet nga organizata prej nga vijnë.
3. Kompensimi i shpenzimeve nga pika 1. e këtij vendimi bëhet nga OB 215, Ministria e Drejtësisë programi 375, njësia kundër Krimeve Ekonomike duke filluar nga 1 Janar 2014.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë